



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2068/14 Prot

Tiranë, më 15/12/2023

**VENDIM**

**Nr. 65, datë 15. 12. 2023**

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5, 6, 7, pikës 1 dhe gjurmën c), dh), dhe e) të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me pikën 1 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Komisioneri”) është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji”,* si dhe mbështetur në pikën 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku parashikohen kompetencat e Zyrës së Komisionerit, ka kryer monitorimin e transparencës proaktive në faqen zyrtare të Autoritetit Publik “Agjencia e Trajtimit të Konkensioneve” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), parashikohet se: *“Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”.*

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.* Në pikën 3 të nenit 4 të LDI përcaktohet se: *“Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik.”.*

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin e Transparencës së Rishikuar, i cili është hartuar në përputhje me nenin 7 të LDI, sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, i ndryshuar, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha autoritetet publike, duke përjashtuar njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Bazuar në sa më sipër, gjatë muajit nëntor 2023 Zyra e Komisionerit monitoroi faqen zyrtare të Autoriteti Publik <http://atrako.gov.al/>, në përfundim të të cilit rezultoi se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 4, nenin 6 dhe nenin 7 të LDI, për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë.

Konkretisht, nga monitorimi i kryer rezultoi se në faqen zyrtare të Autoritetit Publik gjendet i publikuar programi institucional i transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri, por informacioni sipas fushave dhe rubrikave pjesë përbërëse e tij nuk është i përditësuar.

Referuar konstatimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë Autoritetit Publik shkresën nr. 2068 prot., datë 20.11.2023 "*Mbi detyrimet sipas Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar*", nëpërmjet të cilës, kërkoi marrjen e masave të menjëhershme për publikimin në faqen zyrtare të Autoritetit Publik të të gjitha informacioneve përkatëse në Programin e Transparencës. Në shkresën e sipërpërmendur janë pasqyruar edhe mangësitë e konstatuara gjatë monitorimit të Programit të Transparencës, ku u pasqyruan të gjitha kategoritë e informacioneve që rezultuan të papublikuara nga Autoriteti Publik.

Zyra e Komisionerit njoftoi Autoritetin Publik se duke nisur nga data 27 nëntor 2023, do monitorojë sërish faqen zyrtare të tij duke vijuar me procedurën e hetimit administrativ, në përputhje me nenet 18 dhe 19 të LDI.

Pasi është ri-monitoruar faqja zyrtare e autoritetit publik, është konstatuar se Autoriteti Publik nuk ka bërë përditësimin me informacion dhe dokumentacion të Programit të Transparencës.

Referuar pikës 1 të nenit 19 të LDI, përgjegjësia për vënien në zbatim dhe përditësimin e programit institucional të transparencës rezulton e titullarit të Autoritetit Publik, z. Emiliano Gjika.

Në këto kushte, në vijim të kësaj procedure, me qëllim ushtrimin e të drejtës për tu dëgjuar, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet komunikimit me e-mail datë 06.12.2023, drejtuar z. Emiliano Gjika, Zyra e Komisionerit njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 14.12.2023.

Pavarësisht njoftimit, z. Gjika në cilësinë e personit përgjegjës pranë Autoritetit Publik, nuk ishte prezent në ditën e mbajtjes së seancës dëgjimore.

Deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, rezulton se Autoriteti Publik nuk ka bërë të mundur aksesimin dhe publikimin e kategorive të informacionit të programit institucional të transparencës sipas parashikimeve të LDI.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumentet zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet publikohet në faqen zyrtare, autoritetet publike vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Programi i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës. Çdo autoritet publik, përgatit paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të LDI.

Nga monitorimi i zhvilluar nga Zyra e Komisionerit dhe hetimi i thelluar më pas, rezultoi se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor, si dhe nuk paraqiti asnjë argument apo provë për të arsyetuar mospërmbushjen dhe mos respektimin e dispozitave të LDI.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI, parashikohet se: *“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në shkronjën ç/1 të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”*.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për përditësimin e Programit të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, i ndryshuar, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me gërmën “ç/1”, të pikës 2 të nenit 18 të LDI.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në gërmën dh të pikës 2 të nenit 9/1, të gërmës “ç/1”, të pikës 2, të nenit 18, pikën 1 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe gërmën b të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Autoriteti Publik “Agjencia e Trajtimit të Konkencioneve”, në zbatim të gërmave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, të mundësojë aksesin dhe të përditësojë Programin e Transparencës, në përputhje me nenin 7 të ligjit, duke patur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të këtij ligji, si dhe sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 22. 12. 2023.
2. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik, z. Emiliano Gjika, Kryetar i Agjencisë së Trajtimit të Konkencioneve, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Agjencisë së Trajtimit të Konkencioneve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, Autoriteti Publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ky vendim u shpall sot në datë 15. 12. 2023.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**